

VENDIM
Nr. 525, datë 30.7.2004

**PËR PROCEDURËN E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E LËNDËVE PLASËSE
NË REGJISTRIN SHTETËROR TË LËNDËVE PLASËSE PËR PËRDORIM CIVIL**

(Ndryshuar me VKM nr. 963, datë 2.12.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të regjistrit shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil, sipas aneksit A, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili të hapet dhe të mbahet në Ministrinë e Mbrojtjes.

1.1 *Komisioni i dhënies së licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil dërgon një kopje të licencës së miratuar në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë dhe, çdo tre muaj, dërgon pranë kësaj ministrie një kopje të regjistrit të lëndëve plasëse për përdorim civil, me të dhënat e subjekteve të regjistruara në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse.*

2. Çdo subjekt, që prodhon, eksporton dhe importon lëndë plasëse është i detyruar që, brenda 15 ditëve, të aplikojë për regjistrimin e sasisë së këtyre lëndëve në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse.

3. Në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse regjistrohet edhe çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim, nga ana e prodhuesit dhe importuesit.

4. Subjektet që aplikojnë janë të detyruara të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

a) Fotokopje të noterizuar të lejes së importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil.

b) Adresën e saktë të personit juridik ose fizik (tel/fax, celular).

c) Proform-faturën nga uzina prodhuese, me llojin dhe sasinë e lëndëve plasëse, për subjektet importuese.

ç) Dokumentin vërtetues të llojit, sasisë së lëndëve plasëse, për subjektet që prodhojnë dhe eksportojnë.

d) Dokumentet teknike, që i përkasin tipit të miratuar.

dh) Një kopje të certifikatës ekzaminuese, EC.

5. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

(Zëvendësuar me VKM nr. 963, datë 2.12.2015)

ANEKS A

[illegible]

